

MUSTAFË KRASNIQI
ESHTRAT PEZULL

Poezi

Eshtrat Pezull

Botuesi:

*Shoqata e shkrimtarëve
“Fahri Fazliu” Kastriot*

Redaktor:

Brahim Ibish Avdyli

Recensent:

Sylejman Qyqalla

Kopertinë e punoi:

Arjeta Krasniqi

DESIGN:

Artan Krasniqi

Mustafë Krasniqi

MUSTAFË KRASNIQI

ESHTRAT PEZULL

Poezi

Kastriot,2016

Eshtrat Pezull

Mustafë Krasniqi

GJEOGRAFIA E TOKAVE TONA DHE SYNIMET ARTISTIKE TË NJË VEPREJE LETRARE

*-Lidhur me përmbledhjen "Eshtrat pezull" të poetit
Mustafë Krasniqi.*

Kur e mora këtë përmbledhje, pas sa e sa vitesh, që ta redaktoj, më doli një punë e madhe, edhe pse isha në kulmin e punëve të mia të esencës mbarëshqiptare. Kaloi një kohë e gjatë e redaktimit të kësaj përmbledhjeje të poetit, Mustafë Krasniqi, sepse u desh të futesha nëpër këto poezi e të ndjeja gjithë këtë vrushkull të ndjenjave e të synimeve artistike të poetit, sikurse të shkruaj recensionin në fjalë.

Nëpër këto poezi të librit poetik *"Eshtrat pezull"*, me gjithë rëniet e ngritjet, është e tërë përmbledhja poetike e veprimtarit, poetit, publicistit dhe kritikut nga mërgata e jonë e dhimbshme, e cila lidhet për bukuri me çështjen tonë të madhe: **të atdheut shpirtëror pellazgo-iliro-shqiptar dhe bashkimin e patjetërsuar të tij.**

E njoh mirë këtë burrë shqiptar, prej ditëve të para të veprimtarit të LPK-së, por edhe padyshim nga LKSHM-ja, të cilit i mbetem borxh. Sidomos i njoh veprat e tij, ndër të cilat është vepra e veçantë, **"Vështrime kritike për krijimtarinë letrare në diasporë"**, Prishtinë, 2014, me recensentë Martin Çuni e Hasan Qyqalla, dy shokë të vjetër, e botuar nga Ministria e Diasporës së Republikës së Kosovës; **"Lumëgjaku"**, Prishtinë 2002, me redaktor Berat Luzhën e recensent Bedri Islamin, dy miq të kahershëm të mi, vepër e botuar nga ana e Shoqatës së të Burgosurve Politikë; dhe përmbledhjet e tjera të tij, **"Gjarpërinjtë e zinj edhe atje..."** dhe **"Lojë thikash"**, etj.

Poezia është **art i fjalës**. Dikujt nuk i kujtohet kjo çështje. Nëpër vargje ngrihesh ngadalë, por edhe bie shumë shpejt. Për mangësitë e poezisë, kësaj radhe nuk do të flas.

Eshtrat Pezull

E shikoj vetëm anën tjetër të medaljes, anën pozitive të saj. Të ngritësh përmes poezisë është një detyrë e mirëfilltë apo një obligim jetësor. Çdo orvatje është provë e ngritjes. Poeti dhe veprimtari, Mustafë Krasniqi, e bën provën e parë të ngritjes së tij dhe kjo përmbledhje është ngritja e tij e lartë në qiellin e dhembjeve.

Libri i ka katër cikle. Secila ndahet nga cikli paraprak nga një strofë simbolike. Katër ciklet e kësaj përmbledhje simbolizojnë 4 troje autoktone, jashtë Shqipërisë e Kosovës, të cila janë tashmë shtete. Pra, është Mali i Zi, Serbia, Maqedonia dhe Epiri Jugor i Pirro Burrit, që i thonë me të padrejtë vetëm Çamëria, e cila është nën Greqi.

Jo rastësisht e fillon ciklin e dytë të poezive i madhi i kohës sonë- Skënderbeu, në poezinë “*Vorbull kohe*”, ku poeti sikur klith se “*koha migjeniane nuk e di kur vie*”, por “*gjaku i dejve po e qan mjerimin*” dhe shpirti i poetit trazohet rënd. Skënderbeu e ka pasur si simbol në përkrenaren e tij shenjat e Pirro Burrit; ndërsa nga Maqedonia Ilire djalin e Olimpisë ilire, që në të vërtete quhej MERYAMUN (Mirë jam unë), por u bë më i famshëm me emrin historik, Aleksandri i Madh (Si ëndërr u linda), d.m.th. Leka i Madh, apo LEKU, të cilin e ka futur si monedhë të veten Shqipëria.

Tri figura të larta të shqiptarisë, Pirro Burri, Aleksandri i Madh dhe Skënderbeu e lidhin këtë libër poezish. Në poezinë “*Vorbull kohe*” poeti është kthyer në pozitën e tij kritike. **Sikur është tronditur për fatin e kombit të vet.** Shtrohet pyetja: kah po vete ky komb; kah është nisur; kah është kthyer shqiptaria që të shkojë?...

Në këtë përjekje të madhe krijuese, poeti Mustafë Krasniqi i thërret në ndihmë prej krijimtarisë popullore shqiptare: zanat ilire, në rrobe kombëtare.

Në strofën që e hapë ciklin e parë është poezia e këtij cikli “*Ju vrafshin Zanat*”, që simbolizojnë prej antikitetit të lashtë esencën e tyre shqiptare, në të cilën thuhet:

Mustafë Krasniqi

*“Nga djepi i Pirros-Burrë i Shqipërisë
erdhët si ëngjëj të buzëqeshur,
të pushoni pak u ulët në Iliridë
e Dardanisë së vjetër ia hodhët krahun!”*

(Ju vrafshin Zanat)

Zanat janë të veshura me fustanellë të bardhë, që do të thotë se gjithmonë kanë qenë pellazgo-ilire-shqiptare dhe *plagët i lidhin me lotë*, që është një varg i fuqishëm i poetit. Ato nuk e kursyen as veten e tyre për të mirën e kombit. *“Vdekja e pa kohë”* vije në profilin gazetaresk shqiptar të Shqipërisë.

*“Dheu i im
peshë eshtrat i kam”-*

thotë poeti Mustafë Krasniqi, në poezinë e parë që i kushtohet **Isa Boletini** (*Me eshtrat e mi*), eshtrat e të cilit kanë mbetur pezull, sot e kësaj dite, duke pritur të kthehen në trojet e veta, **në një pikë e trojeve autoktone shqiptare**, të shpërndara nëpër 5 shtete të tjera, por që ëndërrojnë e përpëliten deri në gjenocide të papara, për bashkimin e tyre etnik. Ato troje nuk kanë ende gjasa të jenë *“të bashkuara”*, sepse të gjithë armiqtë shekullorë të shqiptarëve, rreth e rrotull trojeve tona, janë të bashkuar në një betim të fshehtë të tyre: për të ndarë e copëtuar më tutje këtë komb të vjetër të botës, kombin pellazgo-iliro-shqiptar.

*“E kush po luan
me eshtrat e mi?!...”-*

shfryen poeti, në fund të kësaj poezie. **Isa Boletini** është vrarë në Mal të Zi, nga armiqtë shekullorë të shqiptarëve. Të vrarët e tillë, si Isa Boletini, nuk kanë kurrë të ndalur; pardje, dje e sot; si p.sh. Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka e Bardhosh Gërvalla, që vijnë në kundërshtim të qindra të vrarëve kështu, në altarin e lirisë. Pushka kërcet prore ndër mileniume; e jona dhe e armiqve tanë. Por, ne, nuk u shuam tërësisht. Ne, jemi gjallë, shqipe tërësisht dhe shqiptarë. Vdekja vjen deri në atë pikë sa të kërkohen të pagjeturit. Poezia, që titullohet *“T'i kthehen pritjes”*, ndër të tjera thotë:

Eshtrat Pezull

*“E liqa të ka groposur
në një gropë të madhe
kockat thërrasin pandarë
nën hi prushi...”*

Dhembje e thellë është kjo dhembje. Në qiellin tonë, vie nga një Yll që nuk shuhet.

Ai është një yll ndër mija yjet tona që ngjitet në qiellin e pamjes. Është një Yll i shqipës, i shqiponjës sonë. Por, nuk e lënë të shihet, ata që sulen mbi ne, në të gjitha anët, me kësi lloj vdekjesh:

*“Kohë e vjedhur e përdalë
tinëzisht më qëlllove në zemër
e tri herë gjuajtjes i shpëtova”... -*

i del nga vetja poetit, në poezinë e fundit të këtij cikli, “*Të përgjërohem*”, derisa ai i përgjërohet Shqipërisë, shenjtërimin të tij.

Cikli më i mirë i këtij libri dhe shkrimin e këtij recensionin është cikli i dytë, i cili fillon me këto vargje:

*“Edhe po të ma vëni
thikën në fyt
nuk do të heq dorë
nga gjeografia ime!...”*

(Gjeografia ime)

Gjeografia e atdheut shpirtëror është vija autoktone e shtrirjes së sotme aktuale e viseve shqipfolëse, sepse atdheu shpirtëror i të gjitha gjeneratave të mileniumeve ka qenë gati e tërë euro-azia, por nuk i njeh ende as e tërë bota, sepse janë të banuar prej mileniumeve me popuj të shprishur nga qenia e jonë e madhe dhe e okupuesve. Gjeografia e jonë është e pështjelluar. Prandaj, po i kthehem shqipfolësve, që flasin ende shqip, pra **gjuhën shqipe**; që bëjnë kulturën kombëtare shqiptare; jetojnë brez pas brezi si shqiptarë të vërtetë, pa marrë parasysh se ata ndahen nga dialektet dhe nëndialektet apo quhen nga të tjerët si shqiptar, arbër, alban, arvanitas apo arnaut.

Mustafë Krasniqi

Brez pas brezi i lëmë eshtrat tona në **altarin e lirisë**. Duam të bashkojmë njëherë ata që flasin shqip, ani pse është gjuha e parë e botës, **gjuha nënë indo-evropiane**, por bota nuk e njeh dhe nuk do të njohë, sepse ne jemi kaq sa jemi, të mbetur nga gjenocidet, nga luftërat, nga betejat, nga tentativat e përhershme të armiqve tanë të mëdhenj, që bëjnë prova të na zhdukin tërësisht nga rruzulli tokësor.

Pra, duam bashkimin e etnisë me tokën, mallin e paktë, shtëpitë qindra herë të ri-ndërtuara; bashkimin e vërtetë të etnisë sonë, të lënë peng brez pas brezi në gjuhën tonë, gjakun e tokën amanet; për të ardhmen tonë më të mirë. Sa më i bashkuar të jemi, aq më të fortë do të jemi! Eshtrat e shumtë, të lënë në këtë altar, po e presin gjithmonë këtë kthim të madh. Eshtrat tanë kanë mbetur pezull. Edhe sot, ato janë pezull para këtij altari. Një bashkim qe miliona vite i parë është më afër të vërtetës. Ai pret që të përbushet. Në poezinë *“Eshtrat pezull”*, Mustafë Krasniqi, thotë:

*“Sytë e mbytur në gjak,
atdheun që t'a puthte
i vlonte peshë kraharori!”*

Kush guxonte të mbytej në gjak e kush kishte përherë një intencë permanente të puthte tokën e shenjtë të atdheut, pos atyre që eshtrat e vetë, në gjenezë të krijuara e të rritura me shumë vuajtje të prindërve e të tyre, ndër rrahje, shkatërrim e luftë të armikut kombëtar, **ti lë peng në altarin e lirisë**. Ata që u bënë **theror** në këtë altar; ndër betejat më të vlershme; në një mbrojtje të shenjtë të fëmijëve, pleqve, vëllezërve dhe motrave; në mbrojtje të truallit të gjyshërve, etj. janë të destinuar nga fqinjët tanë, rreth e rrotull atyre tokave, të cilat ende nuk janë shprishur; që ende nuk janë shpërfillur; që ende nuk janë harruar tërësisht nën gjuhët e huaja e artificiale.

Kjo është shenjë e gjallë e sakrificës me jetë, në shërbim të idealit:

Eshtrat Pezull

*“Në ëndrrat e pritjes
mëngjeset qulloren
me mall për atdheun
shpirti na rri peshë.*

*Zgjohuni bijtë e lokes
të pështjellur me flamur...”*

(Etnia po na pret)

Pra, etnia po na pret jashtë kohës sonë, në mënyrë që të bashkohet vetvetiu toka dhe kombi, aq sa është e mundur që të bashkohet kjo tokë. **Bashkimi jep fuqinë.** Neve, na tretet fuqia e jonë, që ta mbrojmë çështjen ende të pazgjidhur kombëtare:

*“Blozë e hollë
nëpër rrugë peshë janë
gjarpërinjtë e mendimit”.*

(Fytas me kohën)

Kjo është përpëlitja e jone e madhe me kohën dhe mendimet që ajo i ushqen për ne, e që janë me vërtetë **gjarpërinjtë e mendimit.** Poeti thërret **ëngjujt e lirisë,** sepse ata e fitojnë këmbëngulshëm gjithësinë, derisa në këtë hartë të madhe gjeografike, do të plasë një ditë topi i etnisë.

Dihet se në një “natë vrastare”, e zhbiron tërësisht poetin, derisa thotë:

*“të skuqura thikat
si hartën pellazge
në mes të errësirës
idhnisht më qëllon...”*

(Kur nata të vret)

Nëpër këtë kohë vendimtare; me hije apo fantazmë; nëpër bubullimat e pandalura për të fituar këtë liri të paktë, me gjakun e njerëzve të rënë fli për këtë ditë, zgjohet edhe lugati i shekujve kundër teje:

*“e gjaku im
i pafaj i mërdhirë
në dimrin e madh*

Mustafë Krasniqi

*nën thundrat e hekurta
mbetet...” (Kthena atje)*

Sepse, po aty, në fund të poezisë shton:

*“Një ditë
edhe skeleti
do të thahet
nga malli!”*

Një artist vdiq; një Tiranas, Çam, Preshevar, Ulqinak, Shkupjan e Prishtinas poeti i përjeton ashtu siç i kanë mësuar armiqtë tanë kombëtar- të zgjasin *“fjalët thika”* në mes njëri-tjetrit; poeti Mustafë Krasniqi i këndon me mall të pashuar lulemotrës së tij- Toblicës, në vjershën e këtij cikli, *“Lulemolla”*:

*“se unë jam
motra tjetër e jotja
që tmerrësisht të pret
te guri i oxhakut!” -*

pra, mollës së kuqe, të kuq si gjaku, të cilën, *“as gjeografia/nuk e përmend”*, i cili, dihet se shënon vendin ku është kufiri i jonë etnik, nën Serbinë e sotme.

Na vije lutja në gjuhën shqipe dhe në djepin e vërtetë të lindjes së këtij poeti, *“diku / në tokën ilire”*, edhe pse serbët e nderojnë si *“tokë të tyre”*, e turqit dhe Erdogani si *“tokë të tyre dhe të Sulltan Muratit”*, që e ka vrarë Millosh Kopiliqi, nëpër fjalimet që i mbanë Erdogani në Kastriot, pa i vënë syrin asnjë gazetar shqiptar, sepse ajo nuk është tokë as e serbëve dhe as e turqve, por **pellazgo-iliro-shqiptare**, prej fillimit të kësaj bote. Poeti thotë:

*“Për ty
e kapërceva ëndrrën
me krah të bardhë
për në qiell...”*

*u luta thjesht
pa frikë
e lajka*

Eshtrat Pezull

*për ty-
gjuhë
e atdheut tim*

*e mbarova vargjet
lutjet e shekujve*

*dikur u ktheva
si engjull
në tokën pellazge”.*
(Kapërcimi i ëndrrës)

Poeti e di se edhe kjo është truall i atdheut shpirtëror të gjuhës shqipe, i cili është shumë më i madh se sa territori i **Shqipërisë**; i **Kosovës** dhe jashtë saj trojet e vjetra të **Dardhanisë** (*Dardanisë, sepse joshqiptarëve nuk ua nxjerr gjuha “dh”-në shqipe!*); **Malit të Zi**; **Maqedonisë Ilire**; **Greqisë**, si shtet, sepse e “shpallen” me dhunë, edhe pse 4 milion arvanitas i mbanë në vete, e që janë të origjinës sonë, por që e flasin gjuhën artificiale “**greqisht**”, me gjithë gjuhën natyrore gjuhën e vjetër shqipe; por edhe **Turqia** me arnautët e saj, që janë edhe ata ilirë, pellazgë dhe shqiptarë, por nuk e dinë gjuhën shqipe, sepse pushtetarët ua kanë ndaluar shkollat shqipe.

E kemi thënë edhe njëherë më parë se atdheu i ynë shpirtëror ka më shumë toka të vetat, territor i shtrirjes së arianëve ilirë apo albanëve ilirë, apo pellazgëve ilirë, por një pjesë e madhe e tyre nuk e flet gjuhën shqipe dhe ka mësuar gjuhë të tjera.

Eshtrat mbesin pezull në kohë derisa të vie kjo ditë e madhe. Kjo është një vorbull e madhe e kohës për të cilën shpirti i poetit trazohet rëndë. Ajo, ndoshta do të vie...

Cikli i tretë nisat prapë me vargjet e më poshtme:

*“Mbi honet e djegura
në vrap fushe
me lot në gushë*

Mustafë Krasniqi

u thave etjeve tona”.(Malli i atdheut)

Kudo e ndjekin përherë miqtë shpirtëror nga dheu i tij që lidhen me gjitha trojet autoktone. Malli i vendlindjes; malli i babait; malli për nënën e tij; malli për motrat; malli për djalin dhe vajzën; nipat e mbesat; fëmijët që e thërrasin “*xhaxhi poet*”, etj. Malli i atdheut e ndjekë kudo. Çdo gjë përfundon në “*shportën e zanave*”, mbas një kali të bardhë, duke “*therur shpirtin/ me tel çiftelie*”, si në një agullim...

Edhe ciklin e fundit e hapë strofa simbolike, nga poezia “*Modernizimi i fundit*”:

*“Sa vështirë të jesh burrë
sytë padashje
të vënë në kurth
në ndonjë qëndrim të veçantë
kokën ulur
duhet ta mbash”.*

Është e pamundur të anashkalosh lirikën intime “*Besniku i dashurisë*”, në të cilën dashuria shkrihet tërësisht në vajzën shqiptaro-pellazge. “*Lumëmalli*” derdhet më tutje deri sa të zgjohet me “*Shpirtrat e trazuara*”. Lakmia shqiptaro-pellazge shkon përtej ëndrrave, për të mos qenë aq realisht. Unë po e marr këtë poezi, me titullin “*Lakmia*”, për të parë çka vjedhin nga kulturat e huaja dhe atë çka është më e ligë, gratë e vajzat tona. Poeti shfrynë ndër vargje:

*“Mos lakmo
lakuriqësinë
as çarçaf të zi-*

*krenohu shqip
si një rreze dielli
bukuri e arbit!”*

Edhe “*Drugëzat*” poeti u drejtohet tradhtarëve që e shkelën tokën e të parëve, të cilët si “*hije i polli nata*”. Disa poetë, që poeti Mustafë Krasniqi i identifikon si “*poetë të gjithësisë*”, atyre, me energjitë pozitive “*varqjet u vijnë*

Eshtrat Pezull

papritur”, “*ku puthet/këmba me baltën*”, sepse kështu ata i nxitë poezia, siç thotë poeti i ynë në poezinë “*Përtej bukurisë*”. Në poezinë “*Tmerrimi i korbave*”, e që janë armiqtë tanë, e thotë për bukuri si është lënë flamuri i ynë kombëtar.

Autori i fshikullon të gjitha manitë negative në këtë përmbledhje. Pra, vinë manitë më të liga të ashtuquajturve “*shqiptarë*”, p.sh. karrieristëve; ëngjëllushkat si lavire; tipat vandalë; drugëzat apo tradhtarët, e deri te “*O i ziu i fundit*”, të cilët janë vetë shkaktarë të largimit të bijve të vërtetë të shqipes, nga vendlindja, nga atdheu, nga kulla e gurit, etj. Shpirtrat e trazuara janë gjallë e luftojnë me tërë qenien e tyre për bashkimin etnik shqiptar. Ata i lanë vatrat e tyre “*Në kujri zanash*”, sepse nuk mund të njëzoheshin me shpërfilljen e kombit shqiptar.

*“Dikush
si dhelpër
fuqishëm i thyejnë copat e atdheut”
(Thyerja e vetme) –*

thotë vetë poeti, mu siç i kanë mësuar armiqtë e përhershëm kombëtarë. Nuk ka gjuhë “kosovarishte” në Republikën e Kosovës, por gjuhë shqipe, deri në bashkimin e Shqipërisë! “*Modernizimi i fundit*” në këtë përmbledhje është modernizim i tepruar. Sepse është vështirë të jesh burrë, në këtë periudhë ndjenjash, kur njeriu duhet ta ulë kokën, për ta marrë kafënë “*nga gjiri i bardhë*”.

Këtu, përfundon përmbledhja e poezive. Unë, kam folur vetëm për gjërat pozitive, në raport të intencave të mia kombëtare. Mund të ketë ndonjë poezi që do të mund të kritikohet, por ia vlen që ta lexoni tërësisht këtë libër dhe të dëshmoni edhe ju ato që ne i vumë re me këtë rast, si redaktor i librit...

Dhashë Zoti i Madh e Mustafë Krasniqi na nxjerr kështu vepra të miral!

Brahim Ibish Avdyli

CIKLI I PARË

***Nga djepi i Pirros-Burrë i
Shqipes erdhët si engjëj të
buzëqeshur, të pushoni pak u
ulët në Iliridë e Dardanisë së
vjetër ia hodhët krahun!***

Eshtrat Pezull

Mustafë Krasniqi

ME ESHTRA TË MI

Dheu i im
Peshë eshtrat i kam

Nëpër copa- copa
Gojë hienash
Shqipëria ende më rri.

Ta fala gjakun
Kur kërkove Ti

Eshtrat më mbeten
Rrugës për në kthim

Kulla e vjetër
më kërkon pa pushim.

Me koburen time
Lordit plak i thash:

Kam një atdhe
Një Shqipëri
Mu në Vlorë
Një shqiponjë
E mbi te
gjithë Etninë!...

Eshtrat Pezull

E ti Mitrovicë,
Te lindja ime
Eshtrat le të më sillen-

Prehem i qetë
Në tokën Shqipe!

Këtu është Shqipëria,
E kush po luan
Me eshtrat e mi?!...

ËNDRRËS SË GJATË

(Mërgimtarët e bashkuar në UÇK)

Për ta thithë gjirin e bardhë
Fluturimthi ëndrrës së gjatë,
Lumenjtë derdhen plot me mall
Për ta prekur dheun e shpirtit.

E të parët me xhaketa gjaku
U puthitën me afsh në përçafim,
Bjeshkët u kallën nga zjarri në vete
E koha u zhyt në pelinin e hirit.

Në shtatë breza kohe u skuqen
Nëpër shtigjet e vdekjes për jetë,
Vdekja përmallshëm edhe ne na preku
Nëpër kthetrat e ngulura nëpër tokë.

Kështu na degdisi edhe njëherë jeta
Dhe loti u shtjerr nëpër luftëra,
Kushtrimit ju përgjigjëm burrërisht
Me plagë shpirti për At-Dheun e lirë.

Nëpër shkëmbinj e nëpër beteja
Për liri ne u bëmë burra,
Nuk ke si ta thithësh gjirin e bardhë
Në një ëndërr-zhigjëndërr të gjatë...

JU VRAFSHIN ZANAT!...

Shkuat dasmorë
Në ëndrrën e lirisë
Në një dasmë të madhe të bëheni valltar,
Diku, në lagjen e Trimave,

E në atë valle shqiponjash
Dikush korbin papritmas e ndjellte,
Të qeshur ishit, por tradhtia u priste.

Zanat e malit mbi ju u lutën
Me fustanella të bardhë
E plagët ua lidhnin vetëm me lotë.

Nga djepi i Pirros-Burrë i Shqipes
erdhët si engjëj të buzëqeshur,
të pushoni pak u ulët në Iliridë
e Dardanisë së vjetër ia hodhët krahun!

Nuk e di pse u thanë:
Mirëserdhët ju o shqipe,
Kot u presin të gjallë loket në vatra
Me duar të hapura e të thata!

Ju vrafshin juve zanat e maleve
Që pas shpine engjëjt na i vratë!

Mustafë Krasniqi

JU...

(Jusufi, Kadriu e Bardhi)

Ju...
Jeni mes nesh,
Bataretë e rrëmujshme
Nuk ju tremben

E gjithmonë
U kthyet në shtatore,
Në mijëra faqe
Po ju gjejmë,

Më të ndritur
Se drita!...

Flatruat
si shqiponja

Koha
Nuk ua thau gjakun

Jeni fillesa e dritës
Ringjallje e Etnisë
Përherë të njomë

E vet ndërgjegjja
E kësaj Tokel!..

KRISI PUSHKA

Në fshat kumboi zëri
Thanë u lind djalë
Klithmat pushtuan kullën
E ushtima mori dhenë.

U lind djalë për tokë
Ushtoi mali me këngë
Dhe Zanat ia krisën në valle
-I ngjafte djali të atit!...

Ata u rriten me besë
Dhe ishin nishanxhinj të mirë
Por babë e bir u grindën
Dhe u prangosën me fjalë.

Për të sotmen, për dritë
Kurrë nuk u ndalën!

LISI I PATHYER

Lisi i pathyer i vargjeve
Nxori figurën, metaforën
Qytetërimin të poezisë t'i thoshte
Rrënjët e mia e kanë një lashtësi
E rrjedhin moti
Që në pellazgji.

Thanë se ike nga kjo botë
Unë nuk e besova
Isha me poezinë tënde
“Unë, biri yt, Kosovë”
Lotët më rrodhën
për ty, o i madhi poet!

Shumë e doje jetën
Në rrënjët e lisit plak

Aty, buroi dashuria
E i rebeluar thoshe:
“Kosova, është gjaku im që nuk falet”!

Në një mbrëmje poetike, në Paris
Çuditërisht të vodhi poezia

E Kosova në përqaftim të pret
Prapë të na tregosh
Si të mori Lisi
Në një tokë të falur!...

VDEKJA E PAKOHË

Ku e le lapsin, miku im
Prita sot një shkrim të ri
T'ua sqaroje rrugën e kombit
Me energjinë e flakur nëpër shkrime

Ç'deshi me ty vdekja, miku im
Nuk e kuptova lajmin e hidhur
Mos ajo të sillej plotë mëri
Se shpirtin do t'a kesh kudo.

Shqipëria do të ngelet pa një zë
Dhe faqet e gazetave pa ty o mik
Rruga e jote do të vazhdojë më tutje
Se dashurinë e mbjelle për Etninë.

Pendëshkruesin na e vodhi vdekja
Ti më pate thënë se kurrë nuk vdes,
Në fushën e meditimit mbete
Projektues i bashkimi kombëtar.

Mustafë Krasniqi

KALËRIMI

Në vrap më vodhën
Rrëshqitjet e hijes

Figurat e shpërndara
Sikur më trazuan.

Kërkoja jetë-gjallëri
Por qahej malli
Dhe qanin bjeshkët.

Në këto meditime
Gushëbardha erdhi

Papritmas
Ma preku zemrën.

Kalërimi ynë
Nëpër poret tua-
Motivi i gjallërimit!

T'I KTHEHEN PRITJES

(Për të pagjeturit)

Nëpër dhembje
Një kohë-hije
U çmendëm
Duke pritur!...

E liga të ka groposur
Në një gropë të madhe
Kockat thërrasin pandarë
Nën hi prushi
Flakën shndërruar e ka.

Le të pëlçasë zëri
Kërkoni
Peng të mos mbetet
Në lotë deti
Kockat pa gur varri.

Lotët e lokes derdhen
Rrugëve në kërkim,
Kockat le të gjinden
Si i ka lënë Satani dikund!

Kockat e vjedhura
T'i kthehen dhimbjes,

A mos kafshohet koha
Duke ju pritur JU?!...

Mustafë Krasniqi

TË PËRGJËROHEM

Kohë e vjedhur e përdalë
Tinëzisht më qëlllove në zemër
E tri herë gjuajtjes i shpëtova.

Herën e parë nga një pushkë e gjatë
Kinse befas shkrepri mbi mua-
Hija e hijezuar e kishte mashtruar.

Herën e dytë në barkë valëzonte tmerri
Sikur rastësisht gjuanin qiellin
Me tyta pushkësh ta vrisnin diellin...

Herën e tretë m'i vidhnin kryqet
E më gjuanin me kryqa të shtrembët
Ata që kurrë nuk kishin pasur njerëzi.

Tri herë më qëlluan
po vdekja s'më kapi
Sot e asaj dite zoti më tha:
"Vrapo pas dritës
Se shpërblim ke nga unë!".

Prandaj, të përgjërohem ty-
O Shqipëri, shenjtërimi im!

Eshtrat Pezull

Mustafë Krasniqi

CIKLI I DYTË

***edhe po të ma vëni
thikën në fyt
nuk do të heq dorë
nga gjeografia ime!...***

Eshtrat Pezull

Mustafë Krasniqi

VORBULL KOHE

Për mall
shkallët e kohës
i kalova nëpër sheshin e teatrit

jo rastësisht
e takova Skënderbeun
e ia putha shpatën më afsh.

Shpirti më është bërë prush
sa po e bart dhembjen

kryq e tërthor sheshit
Kuvendi i Lezhës
është ulur përreth nesh...

Vorbull kohe, Skënderbe,
në Prishtinë apo diku tjetër
teatri i mbërthyer
nuk e di në cilin shesh ndodhet

e ti me kalin tënd
dikund do t'ia mbathësh

Shqipërinë e përvëloi anarkia
e Dardaninë
leckë e zuri dhembja...

Eshtrat Pezull

Qofsh i uruar, o trim i urtë
kohë përvëluese kudo kalon
koha migjeniane nuk e di kur vjen

me duart të shtrira anarkia po shpërthen
gjaku i dejve po e qanë mjerimin,

e kështu
po na ndahet sheshi

e mua shpirti më trazon!

MALL DASHURIE

Nëpër rreze dielli
me këto rimëvargje kohësh
meditimet si hije më ikën
e humbin në kohëdhimbje.

Në akrepin e njëzetekatërtë
një gotë verë të kuqe gëlltis
më zuri një trazirë kohe
dhe hëna pat mbërritur në agim.

Nga dëshpërimi pëlçet filxhani
xixëllimë yjesh përplasen qiellit
shiun që po bie për ty
sikur shigjetë përvëluese duket.

Aty shkrihet dashuria
e më flet gjaku rimëvargjeve të mia
nëpër zjarrin e thellë të meditimit
shprushen n'pafundësi ëndrrat e mia.

A më lë të të puth një herë ballin
sepse kam etje në mëngjesin e kallur,
po ta përkëdhel trupin gishtërinj
që dridhen nëpër flakën e dashurisë...

Nuk jam zhytur në një gotë
po ndizem flakë nga malli!

NË KËRKIM

Si zog pëllumbi të prita
papritmas vërsloi lumi
nga dhembja toka u shemb
e bubullima mori dhenë...

Për habi u hap dhe qielli
pëllumbat e lodhur në fluturim
u zunë në një qoshe nga breshëri
ende në pritje...

Vetëm unë dhe ti e dimë
mbi atdheun e etërve
toka skuqet tërësisht

ne, prapë në kërkim të etnisë...

Mustafë Krasniqi

ESHTRAT PEZULL

Në pikë të natës tmerr
Ëndrra këlthiste në mua,
I humbur nëpër ankth
Koha kalëronte me hijen.

Hije eshtrash me lutje
Sytë e mbytur në gjak,
Atdheun që ta puthte
I vlonte peshë kraharori!

Ëndrra hije u bë e largohet
Zëri mbeti i padëgjuar,
Eshtrat pezull në çast
e zëri dridhi kushtrimin:

-Mos humbni nëpër ankthe
Eshtrat po presin kthimin!

ÇAST I RËNDË

Në mugëtirë
mos humb rrugë
nëse edhe si hije
të dëftohet
djalli i verdhë.

Fytyrës
përplasje e renegatëve
kohën e tmerrit
mbjellin nëpër vargje...

Sipër kohës qëndron
nëse harrohesh në gjumë

as zoti nuk të fal
etjen nuk ta shuan
me një shtambë...

Ti, ngul këmbë
si engjell rri
e mos u zhyt
nëpër vargje!

Mustafë Krasniqi

ETNIA PO U PRET

Me valle e me këngë
në mes qiellit kaltërosh
rrezeagimi na vjen

e pranvera
do të mbetet gjallë.

Në ëndrrat e pritjes
mëngjeset qulloren
me mall për atdheun
shpirti na rri peshë.

Zgjuhuni bijtë e lokes
të pështjellur me flamur,

në sofrën e shtruar
që moti
dheu i tokës amnore
u pret-

ndoshta nëpër kohë
Etnia po ju pret!

LUGAT I KOHËRAVE

Në ekran kur të pashë
u stepa habie
me të njëjtën fytyrë
si hije m'u dëftove.

Lugat me dy fytyra:
dikur shërbëtor ishe
Sot atdhetar i shtirur!...

Gjarpër me dy thimtha
Përbindësh i tetëdhjetë e njëshit
si engjell dukesh o djall
dhe këngën e Bilbilave
e përsëritë!

Gur mbi gurë dje
hidhje mbi rininë e UÇK-në
Bacën Adem
dhe gjithë burrat
që e donin Shqipërinë!

Sot, çirresh e sillesh
si "trim me fletë"
as falje s'u kërkon
atyre që i torturove!...

Tani, je lugat i kohërave
me dy fytyra!

BULLIMË

Kovën me ujë ia solla
nga kroi i moçëm
sikur etjen e shoi
e lotët çurg i rrodhën,

dhe, ashtu,
nën vapën e kohës
me shat në dorë
edhe i leckosur
gjyshi im
me këngë gjysmë vaji
kësulën
se hiqte nga koka...

Shikimi i tij më digjte
përtej kohërave thoshte shumë
koha e hekurt po na merrte
e plisat në kokë
na u përgjakën...

Kujtoje këtë ditë biro
furtunat s'ndalen pa mur.

Në amshim iku kaherë
gjyshi i tretur ndër vuajtje,

Bubullimë
kanë mbetur kohërat
që kujtimet t'i ruajnë.

FYTAS ME KOHËN

Blozë e hollë
nëpër rrugë peshë janë
gjarpërinjtë e mendimit.

Me vrap kuajsh
hingëllima
fërgëllimë shpatash
brigjet e kohëve tmerroheshin.

Me karta fati
fallxhinjtë lozin
kambanat e frikësojnë vrapin,
peng, me kusht e linin lojën...

Në hartën e gjeografisë
topi i etnisë le të plasë

andaj, ëngjëj të lirisë
mos mbani frikë-

këmbëngulshim
e fitojmë gjithësinë!

Mustafë Krasniqi

HIJE APO FANTAZMË

Nëse nuk ishe ti
ai i ringjalljes
pse poshtërohesh;

Nëse lakmia të ka trullosur
pse e varfëron shpirtin;

nëse të ka munguar guximi
pse harlisësh
mbi shenjtërimin;

nëse e ke shkelur gjakun
do të ngritën
edhe të rënit

e do të qeshen
me të gjallët.

KOHË VENDIMTARE

Sikur humba
në sytë e tu

Në palmë rrushi
Në marrje ere
u dogja

me palore në dorë
palmuç përdhe.

Ngrihuni
me pallë në dorë
po mbarove i dehur
qesh
edhe dheu...

Mos e harro vdekja
se vdekja
nuk të korit
për dhé,

pra, kështu
mos harroni
t`ua prekim
fytyrën e shndritur
me duart e përlyera,

Ju, të vendosur
çasti i kohës
po ju thërret!

Mustafë Krasniqi

KUR NATA TË VRET

Natë vrastare
me sy të fshehur
më zhbiron

të skuqura thikat
si hartën pellazge
në mes të errësirës
idhnisht më qëllon...

Iku koha e rrapëllimave
Kuajt hije të liga
ç'më rrëmbyen?!...

Kjo s'është dashuri
Kur nata të vret
tinëzisht.

KTHENA ATJE

Kthena atje
tek livadhet e kujtimeve
tek arat e amanetit
tek lahuta e gjyshit...

Kali i bardhë pa fre
nuk dimë
ku e ka kalorësin

e gjaku im
pafaje i mërdhirë
në dimrin e madh
nën thundrat e hekurta
mbetet...

Athua
kah na degdisi jeta
kush e kalëron atin!?

Një ditë
edhe skeleti
do të thahet
nga malli!

Mustafë Krasniqi

PO IKIN

Po ikin
hijet e tmerrshme
nga grushti i pushtetit
që po shkel dinjitetin
e jetës së lirë,

Po ikin-
ata që janë të fyer
e pa shpresë
mbetur
rinia e mjerë!

Mbarë po ikin
me kokë në dorë

e ku shkojnë
askush nuk e di

hijet e zeza
u kënaqen
me vdekjet në kufi...

Bota po qesh me ne
qeveria soditë me gas
fatin e popullit

e ata
po ikin
nga shpresat
e humbura!

LULEMOLLA

(Toplicës)

Lulemotër moj
sikur më je tharë
në pritje motesh
këngën e pashpirt
aty e ke varur...

As gjeografia
nuk të përmend
lavra e harruar
moti ka mbetur...

A do të më kthehesh
në ndonjë kohë
lumë motra ime
moj lulemollë

se unë jam
motra tjetër e jotja
që tmerrësisht të pret
te guri oxhakut!

ARTISTI

Artisti vdiq
funerali vazhdoi
kortezi s'u ndal
skena u mbyll.

Artdashësit duartrokitën
me lot për faqe
perdja u hap
muzika u ndal.

Me sy hapur pamë
në udhën e shkronjave
vdiq në skenë i madhi
heroi mjekërbardhë.

Thonë artistët s'vdesin
mbesin në shiritat e gjatë
deri në mileniumin
e artit të pavdekshëm.

DORA E PATHYESHME

E shikoj të tërën:
një Tiranas
Çam
Preshevar
Ulqinak
Shkupjan
e Prishtinas...

fjalët thika
zgjaten në mes vete...

A nuk e keni harruar
të zgjatni dorën
me besën e pathyeshme!

Mustafë Krasniqi

GJEOGRAFIA IME

Çfarë kërkojnë
nga unë-
nga unë,

ç'faj kam unë
pellazgu i ri
vetëm pse dua
pak drejtësi
atdheun e bashkuar
e liri,

s'jam lypsar rrugësh
për drejtësinë
e lirinë
sepse i kam dhënë
ushtar e gjeneralë
nëpër shekuj,

e tani, një dreq kohe
djall mbi djall
moti më polli
kjo botë
që moti
me të njëjtin shpirt,

edhe po të ma vëni
thikën në fyt
nuk do të heq dorë
nga gjeografia ime!...

KAPËRCIMI I ËNDËRRËS

Për ty
e kapërceva ëndrrën
me krah të bardhë
për në qiell.

U luta i shtrirë
në një barkë
përreth bardhësi....

U luta
në gjuhën time
në djepin e lindjes
diku
në tokën Ilire...

U luta thjesht
pa frikë
e lajka
për ty-
gjuhë
e atdheut tim

e mbarova vargjet
lutjet e shekujve

dikur u ktheva
si engjell
në tokën pellazge.

Mustafë Krasniqi

PËRTEJ VETES

Në çdo fund
zhytet bota
zbathur ikim
përtej vetes,
të krisur
a të lekosur
me të njëjtin stil
fikim dritat...

Eshtrat Pezull

Mustafë Krasniqi

CIKLI I TRETË

***mbi honet e djegura
në vrap fushe
me lot në gushë
u thave etjeve tona!***

Eshtrat Pezull

Mustafë Krasniqi

PËRPLASJA

(Mërgimtarëve)

Djersët
të akullta
na mbulojnë ballin

troku i kalit
në humbje
merr udhë pa kthim.

U ngjeshën ditët
tani
për një
dymbëdhjetë ikën

e troku i gjokut
nuk u dëgjua më,

thonë djersët
gjokun nëpër rrugë
po e verbojnë...

Kulla rënd klithi

në kthim
po e pret
trokun e gjokut.

ËNDËRRIMET

Më rrëshqiti një lot
më shumë se një mall

në lumin Inn
valët në gurgullim...

Ofshana i degdisur
bregu i mërzhitur
nga hallet e mia,

dot s'i mbante
as dhembjet anija.

Iku rrezja e fundit
nata sikur më hante

ëndrra më shprushte mallin
e Drini plak më përqafonte.

Lutja, ëndërrimet
zgjasin shumë

më shumë se jeta!

Mustafë Krasniqi

NGA ËNDRRA

(Babait)

Ëndrra m'i shprush ndjenjat
gjysmë të verbuar pret shikimin
a këndon gjeli
çdo mëngjes të hershëm?...

Pritjet me faculetë
nuk largohen nga mendja
perëndimi- një shekull i mërzisë
që të mos derdhë lot pleqërie
mbahet plaku-
nëpër rrugë humba nipat!

Duhan pinte djali
sikur rrëfëhet baba
e nga trishtimi
e thirrja tim bir me tërë fuqinë...

ëndrra më zbriti te një lum i turbullt
kalëronte një kalë
nga një hije në tjetrën,

kam një ndjenjë e mos ma fshihni
se zëri i tij
ende i gjallë
më tingëllon në vesh...

PËR TY NËNË

Ishin trazuar
ëndrrat
për ty, o Nënë

duke ngjeshur mallin
në dhé të huaj.

Me gjolin e lotëve
shpërtheva ëndrrën,
për erë mali
t'a dërgova për qafimin.

Dritaren nuk e mbylla
t'i kujtoja
duart e bardha,
te oxhaku i moçëm
pogaçen ma piqje
për qefin tim.

Kërkova të përsëritej koha
Me këmishë të bardhë
ti, engjëllushë-nënë
m'i lëmoje flokët
e zëri yt
fort tingëllonte

mos ma humb gjakun
sikur më porositje
se bota
nuk ka fund!...

Mustafë Krasniqi

VOCËRRAKU

(Djalit të vogël)

Me mall
në krahë m`u hodh
i mbërthyer në lot,
buzët i dridheshin
sa më dogji shpirtin
vocërraku im.

Ashtu befas
m`u zunë fjalët
shkrepe he burrë
ma ktheu gruaja
e më erdhi prapë fuqia

andaj
prej lotit të vocërrakut
fjalët më rrodhën
e ma pikëtoi zemrën
sa të shembej
një breg lumi,

Mbaju bir
pëshpërita
se dhimbja
për njerëz është
e ti ma kujton...

IK MOJ DRENUSHË

Pak me shaka
në një mëngjes
pa dashje
e putha
lulëkuqen time.

Nën hije kumbulle
m'u derdhë kafja
për një puthje

e drenushës
papritmas i doli fjala:

“Uh, ç'më bëre
këmishën me kafe
si i përdalur
ma përleve”!

Ik moj drenushë
se më erdhi etja

krua nuk gjeta
por në buzë tua
çiltërisht
u deha!

Mustafë Krasniqi

NJË MASHTRIM

(Nipçes, Lorikut)

Duke e llogaritur kohën
si matematikanët i gabuar
ëndërimi i beftë
më zgjoi frikshëm.

Sa paskam etje
si më erdhi ky mall
derisa po e dëgjoj
këtë vaj fëmije
lotët më rrjedhin...

Ne kërkujmë dritën
e sillemi nëpër botë,
tërthor na shkoi rruga
nëpër këngë...

Me sy të përlotur
më duket se ëndrra
është një mashtrim.

RRITA

(Artanit)

Me gëzim të madh
përshtëndetja ditën
pritja me shpresë
rreshtimin e viteve.

Gjëmonin valët e lumit
mbi bregore duke u rrahur
e i harruar
në meditimet e agut
sa nuk më plasi
fladi i saj.

Në mesin e kësaj kohe
refrenet e muzikës klasike
-urime, urime o trim
sikur më thanë...

Në mesin e dhembjes
u zgjua, sikur për mot
edhe një gëzim!

Mustafë Krasniqi

SHQIPONJA IME

(Arjetës)

Sa më gëzove
moj vogëlushja ime
ëndrrën e shprishur
ma gjallërove
jetës i hape
rrugën e ardhmërisë
shqipja jonë the
se ka vetëm një rreze.

Nga zemra
urata më del për mot
në skenë kur të shohë
në mua rrjedh
një krua nga gjyshi
mund të ma sjellësh
kur t'i plotësosh vitet...

Në këtë rrugë të suksesit
malet dhe brigjet
le të ushtojnë
gëzimi të na dehë
me ardhjen tënde
shqiponja ime.

PESHA E MALLIT

(Motrës)

Qytetit të botës kalove
derdhe lot pse le Kosovën
prapë me ata lot në sy
më dhembje zemre the:

-Sa shqiptarë
të përлотur dyerve të botës
sa peshë e rëndë
qenka dheu i huaj
mërgimi qenka i rënde
edhe për ju;

kthehuni, motrës, në atdhe
pesha e ëndrrave
po u shkakton plagë të reja
lotin e dhembjes e mbani
e shpirtin e çiltër mërgata
ua trazuaka;

kthehuni, në atdheun tuaj
fëmijët botës mos ia falni
buzëqeshjen mos e thani me lot
se kulla ka mall për ju;

kthehuni
e shëroni plagët e kullës

ankthi, sikur peshë
ua mbanë shpirtin!...

Mustafë Krasniqi

MBESA

Që kur u linde
mbesë e bukur
shtathedhur
vetë shqiponjë
nga bota e mërgimit
të përqafoi
me lot gëzimi.

Që kur u linde
në kullën e gjyshit
xhaxhai fliste
se po vjen
një shqipe.

E nga kjo botë
mërgimi i dhimbjes
të uroi jetëdritë
në atdheun e lirë!

UDHA E KTHIMIT

Ma zhuriti zemrën
nga shtrati i trishtuar
kur u zgjove
me zërin e dridhur
që thërriste,

ma vodhi jetën
fati i zi, katran
me mall qava historinë
e me nostalgji
vendlindjen time.

Udha e kthimit
mëtimi, përqaftim i gjyshit
sëmbon në shpirt plage
e për ty lumi
vorbull shkon.

Hiqur botë e tmerrit
s'jam i krisur siç pandeh
në shpirt kam
tërë etninë

e për të më vegon
drita e gjallërisë.

Mustafë Krasniqi

XHAXHI POET

(Fëmijëve të mërgatës)

Edhe ne jemi fëmijë
xhaxhi poet
duam pranverën
pa lajka
fluturën mbi kullën
e shqipeve tona.

Edhe ne jemi fëmijë
xhaxhi poet
nga larg digjem
si qyqarë botës
mbetur jemi,
në të bukurat
fjalë shqipe
belbëzojmë.

Shkruaj poet
edhe për ne
si flutura të kthehemi
në erën e luleve
tek zëri i ëmbël
i bilbilave
që balta
vetëm shqip
të kupton.

Eshtrat Pezull

Shkruaj
xhaxhi poet shkruaj
për mua të humburin
pa fajin tim-

vargjet tuaja
shpirtin
le të na e prekin!

Mustafë Krasniqi

IKJA E DRITËS

(Humbja e syve të babait)

I zjarrtë flisje
e doje me shpirt etninë

në përpëlitje
vjedhurazi
perçja e errët
ta mori dritën.

Kështu
humbi shikimi
mall për bardhësi

e unë e kuptoja
si e luftoje errësirën
të të mos linte
Drita
Etnia!

MALLI I ATDHEUT

Në binarët e mallit
zhuriten ëndrrat
për etjen time.

Mbi honet e djegura
në vrap fushe
me lot në gushë
u thave etjeve tona.

Si mund ta kuptosh
përplasjen e rrezemallit
botë e përmbysur
që rënkton nëpër flakë

dhe nuk e di
çka është ringjallja?!...

Në meditime udhësh
u dogja i tëri
e më rrodhën lotët

sikur nuk e njihni
mallin e atdheut!

Mustafë Krasniqi

NË SHPORTËN E ZANAVE

Shpirttherur
për lirin mburojë
hije mbetur
në shterim kohe.

Kali i bardhë
hapin e ndal në vegim
për zot shale pret
deri në dhembje,

ndërsa unë
duke therur shpirtin
me tel çiftelie
sytë nga vendlindja
derdhem në shterim.

Tani, kulla e gurit
me një therrë pranë saj
derën moti të mbyllur
në strofull zanash rri.

As një lajm shprese
nuk jepet si kumt
e kur do të ktheheni
në vatrat e atdheut-

të mos e lëmë kështu
në shportë mallkimi!...

AGULLIM

Në tisin e agzotit
mbërthyer në vazo
koha e ikur
është përvjedhur
në një agullim të zbehtë.

Përtej brigjeve po e pres
hipur në një kalë të bardhë
valëzimin e rrezeve-

ëndrrën e shekujve.

Mustafë Krasniqi

CIKLI I KATËRT

***Sa vështirë të jesh burrë
sytë padashje të vënë në kurth
në ndonjë qëndrim të veçantë
kokën ulur duhet ta mbash!***

Eshtrat Pezull

Mustafë Krasniqi

BESNIKU I DASHURISË

Në breg të lumit
rebelim

buzët shkrumb na rrinin.

Ujit shkumë
si rrallë herë
shëtisnin sytë...

Befas shtrënguam duart
puthjet i ndiem
në qeniet tona

mbetëm besnikë të dashurisë!

Nuk u inspiruam nga filmat
thjesht nga shpirti
dolën puthjet-

kaherë
vasha shqiptaro-pellazge
ka hyrë
vetë
në jetën time!...

JETË E VDEKJE

Pa dashur
me një njeri të thinjur
ndodhem në një dhomë,¹

një karrocë me rrota
me jetën bënte gara
shkonte para
kthehej prapa.

Ajo nuk kishte faj,
e përditshme
shkonte kjo lojë...

Kështu, nata e mundi
e karrocës sikur i vinte keq
pse lojtari
nuk luante më me të!...

Karriga me rrota
humbi një shok

tinëzisht krevati
e shpuri në një tjetër mot-

jetë e vdekje
përplaseshin në dhomë...

¹ Me këtë pacient kam qenë së bashku në një spital rajonal.

Mustafë Krasniqi

LUMËMALLI

Mbi ne biseda në erë
sikur jemi bërë urë e gurë
na lëndon deri në përgjakje
Lumëmalli, vendlindja ime.

Hapur dritarja rri për mot
lokja me rrudha të ballit
për një pëllumb na dërgon fjalë
që të mos qajë kulla kot.

Sikur jemi bërë urë e gurë
digjem edhe për një përrua
e në këtë dhé tjetër
me dhembje malli rrojmë.

Lumëmalli derdhet në kohë
me ëndrra prore të atdheut,
ne jetën e bjerrim kot
në një dhé që duket i huaj...

NJË FLETË E VEÇANTË

Urime 8 marsi
nënë e dashur-
më e bukura në botë
trimëreshë e fjalës.

Më je një engjull
këshillat tuaja rreze jete,
me buzët tuaja mjaltë
zemrën ma shëron me fjalë.

Prano dhuratë lulet e mia
o shpirtëngjell
për tetë mars
sepse po ta shëroj zemrën
sikur me një përqafim!

Sa i fuqishëm ndihesha
vetëm në prehrin tënd-

margaritar i jetës simel!...

Mustafë Krasniqi

EDHE NJËHERË MOTRËS

Digjem,
rrëfhem n'ëndërr
kur ia shoh motrës
mallshëm
lotin n'sy

therrë dhimbja
trupin ma përshkon.

Ikin vitet
pranverat vijnë
dallëndyshe
në fluturim
merre këtë lule
m'ia dërgon
motrës dhuratë.

Rrugëve t'botës
i thinjur kalëroi
për prehje pres
ngrohtësinë
e dheut tim...

Për ty, motër
malli më djeg!

SHPIRTRAT E TRAZUARA

Zgjohuni
me lindjen e diellit
na thërrasin heronjtë
mëngjeseve të hershme

në gjumë
të mos harrohemi.

Natën
të dehur mos e kaloni
atdheun mos e fyeni
dhe mos e mjeroni kështu
masën!

Shpirtrat na i keni trazuar
kur e shohim mjerimin
mos bëni lojë të pistë
me gjakun tonë...

Një ditë, do të verbohemi.

Mustafë Krasniqi

KTHJELLONA MENDJEN

Të lutem
Kthjellma mendjen:

thellë në lëndinë
në mbrojtje nderi
zëri i dhimbjes u mbyt.

Hijet e përjargura
engjëllusheve
me lojë thikash
ua vriste lirinë

e kurrë nëma
hijet s'i mori

as vetë Zoti
s' i ndëshkoi...

Çuditërisht
i shoh krejtësisht të lirë,

shpirtin s`ua ka thyer
as lakuriqësia
as gënjeshttrat
as laviret...

Eshtrat Pezull

Ne, sikur bëjmë sehir,
i fajësojmë kot
engjëllushet,

o Zot, o Zot,
kthjellona mendjen!

MALLI

Atë ditë
Në ikje
hapi,
mall i dheut
më përcolli
me gotë uji pas
në stërpikje.

Kalorës i thinjur
unë biri yt
për ty
digjem.

Më prit
pa frikë
do të kthehem
moj engjëllushë

do të të puth
me afsh
deri në dehje...

E vetmja rreze
shprese më je.

LAKMIA

Lakuriqe
nuk të dua
as të fshehur
nën çarçaf të zi,

me të vjedhurën kulturë
anglo-amerikane
apo aziatike...

Ke qenë dikur
e bukura e arbitrit
dhe kulturat e tjera
ta kishin lakmi.

Mos lakmo
lakuriqësinë
as çarçaf të zi-

krenohu shqip
si një rreze dielli

bukuri e arbitrit!

Mustafë Krasniqi

KUJRI ZANASH

Për lisin mburojë
therur shpirti
hije e mbetur
në shterim kohe

e kali i bardhë
hapin e ndal në fushë
pa zot shale pret
e pret pritjen.

Duke therur shpirtin
me telin e çiftelisë
sytë nga vendlindja
derdhen në shterim,

kulla e gurit
me një therrë të tharë
derën e mbyllur moti
e në kujëri zanash rri...

Kthehuni për tokën
ku atdheu u pret-

në kujri zanash mos rrini!

THYERJE E VETME

Në tempullin e dijes
plasi dhimbja
në vitet e ikjes të kafshonte tmerri,

në një paqe të heshtur
zgjohen tipat vandalë!...

Si hije e prishur zbriti nga trishtimi
gojë shkumuar shau deri në themel

nuk ishte i vetëm në vjellje
se në kokën e mykur
i kishte mbetur
vesURREJTJA
sharja deri në fund!...

Nga bishti i hypi shtigjeve të mallkimit
dhe shkoi deri në maje të Republikës

heshtur e arriti qëllimin
ende fyen
bijtë e kombit!

Prapë në ndjekje të këtij vandali
këtij mikrobi të Republikës,

Mustafë Krasniqi

dikush po vdes
për bashkimin

e dikush
si dhelpër
fuqishëm i thyejnë
copat e atdheut!...

DRUGËZAT

(Tradhtarëve)

Ata që shkelën
këtë dhé
ishin të ftohtë
në shpirt

e në hije të hënës
të pafytyrë

i vënë drugëza
fytyrës...

Hije i polli nata

drugëzat
ndërruan rrugë
kur ia mbathën...

Në atë udhë turpi
mjerë koha
që ju pati!

Mustafë Krasniqi

PËRTEJ BUKURISË

Mjaft poet të gjithësisë
në energjinë pozitive
vargut nuk ia lënë
tek ikën përtej bukurisë.

Ato rrugë kishin peshë
largësia të djeg e të përvëlon
ty flokëthinjur dhe mua.

E di se lutesh për çdo ditë
Ulur pranë teatrit
dhe e ngrohë shpirtin

vargjet të vijnë papritur
ku puthitet
këmba me baltën,

poet, e di
se ky zjarr
më djegë edhe mua!...

TMERRIMI I KORBAVE

Lart në qiell
fluturoi shqipja

korbat u trishtuan

plisat e bardhë
krenare e lanë
shqipen
në flamur.

Krahët e shqipes
në mbrojtje nderi
kthetrat i lëshuan
mbi zogjtë
e shkinës.

Plisat e bardhë
qëlluat pa frikë

korbat u tmerruan!

Mustafë Krasniqi

LE TË ZHDUKET NATA

Si tis më erdhi
rrezja e hënës
i dënesur për tokën
qava
e nga etja që kisha
nëpër errësirë
e putha lulen.

E ndjeva mugullimin e aromës
se si shpërthejnë sythat
pranë dheut tim
nga lindja

prita zbardhjen e ditës
afshi sikur më mbyti
dhe e thura
mbi një letër të bardhë
ëndrrën e zjarrtë!

I magjepsur pas teje
mendja m'u dogj,
sikur më përvëloi
në një fustanellë të bardhë.

Sikur ta përsëritja kohën
nuk do t'i thyeja ëndrrat

Eshtrat Pezull

për ty, dheu im
do të flijohesha
si shqiponjë!...

Le të ikë nata
se me ty
me një këngë ëndrrash
do të rroj!

Mustafë Krasniqi

KARRIERISTËVE

Kohë mjerimi
i ligu u bë trimi
u rrjep atdheu
nga ky soj i përdalë.

Ata
për ironi
urinojnë në lëndinë
mbi luleprilli!

Atdheu im,
qesh apo qaj
në këtë kohë plaçke,

dje dhe sot
me të njëjtën këngë
kam mbetur!...

O I ZIU I FUNDIT

O i ziu, i fundit
i tmerrshëm dhe tellall

me gurë në duar
pëllumbat i gjuan
trimat i kërcënon
dhe në buzë varri
tokën e dërgon.

Kur vetën mbaje për zot
mbi të varfrit u çirre
dhe ua vrave shpresat.

O i ziu, i fundit
me duar të shtrira
prore godet
vetëm pas shpine!

MODERNIZIMI I FUNDIT

Sa vështirë të jesh burrë
sytë padashje
të vënë në kurth
në ndonjë qëndrim të veçantë
kokën ulur
duhet ta mbash.

Po u habite
kokën lart ta ngritësh
çajin apo kafënë ta marrësh,
me frikë duhet ta kapësh
nga gjiri i bardhë.

Ky është modernizim i tepruar
me lakuriqësi të shohim-

është vështirë të jesh burrë
në këtë periudhë ndjenjash!...

Eshtrat Pezull

Mustafë Krasniqi

Biografia e autorit

Mustafë Krasniqi, u lind në vitin 1966 në fshatin Shipitullë, Komuna e Kastriotit. Mësimet e para i mbaroi në vendlindje, të mesmen dhe studimet universitare në Prishtinë. Rrjedh nga një familje atdhedashëse, ku më 1920 stërgjyshi i tij ekzekutohet nga makineria serbo-sllave.

Si i ri hyri në radhët e grupeve ilegale (në LPRK-LPK), ishte pranë qytetarëve, aktiv në pajtim të gjaqeve, në aksione konkrete për çlirimin e atdheut dhe më pas dha tërë kontributin për lindjen dhe suksesin e UÇK-së, po ashtu ishte dhe mbeti i angazhuar në çështjen e bashkimit kombëtar, për Shqipërinë Etnike.

Së fundi i është dhënë me përkushtim të madh hapjes së shkollave shqipe në mërgatë, konkretisht në Gjermani ku dhe ka hapur katër klasë, si dhe po e trajton një temë të prekshme, e të pandalshme “... rreziku i asimilimit në heshtje i mërgimtarit”

Autori, Mustafë Krasniqi, pati fatin të vepronte me shumë atdhetarë - dëshmorë të kombit.

Po ashtu ishte edhe njëri nga drejtuesit e demonstratës së vjeshtës së vitit 1989 dhe i shumë proceseve të rëndësishme të ilegales dhe të luftës së fundit të UÇK-së, tashmë dhe zëri i fuqishëm për bashkimin e trojeve, Shqipërinë Etnike.

Si nxënës filloi të merret me krijimtari letrare. Ai merret me poezinë, prozën, esenë, po ashtu edhe me histografinë, si dhe me shkrime gazetarie, analiza, kritikë dhe intervista.

Eshtrat Pezull

Librat e tij janë:

- **Gjarpërinjtë e zinj edhe atje...**
- **Lumëgjaku**
- **Faqe të panjohura të historisë së NDSH-së**
(*Ramiz Qyqalla dhe bashkëluftëtarët e tij*)
- **Lojë Thikash**
- **Gjarpërinjtë e zinj edhe atje... (ribotim)**
- **Vështrim kritik për poetikën e krijuesve të diasporës**
- **Mbrëmja e fundit**

Si dhe në gjashtë libra të tjerë është me bashkautorë.

“Eshtrat Pezull” është libri i tetë. Ndërsa në dorëshkrim ka edhe pesë libra tjerë...

Pasqyra

<i>Recension gjeografia e tokave tona Dhe synimet artistike të një vepre letrare</i>	5
Cikli i parë	
Me eshtra të mi	17
Ëndrrës së gjatë (mërgimtarët e inkuadruar në UÇK)	19
Ju vrafshin zanat!...	20
Ju...(jusufi, kadriu e bardhi)	21
Krisi pushka	22
Lisi i pathyer	23
Vdekja e pakohë	24
Kalërimi	25
T'i kthehen pritjes(për të pagjeturit)	26
Të përgjërohem	27
Cikli i dytë	
Vorbull kohe	31
Mall dashurie	33
Në kërkim	34
Eshtrat pezull	35
Çast i rëndë	36
Etnia po u pret	37
Lugat i kohërave	38
Bullimë	39
Fytas me kohën	40
Hije apo fantazmë	41
Kohë vendimtare	42
Kur nata të vret	43
Kthena atje	44

Eshtrat Pezull

Po ikin	45
Lulemolla (toplicës)	46
Artisti	47
Dora e pathyeshme	48
Gjeografia ime	49
Kapërcimi i ëndrrës	50
Përtej vetes	51
Cikli i tretë	
Përplasja (mërgimtarëve)	55
Ëndërrimet	56
Nga ëndrra	57
Për ty nënë	58
Vocërraku(djalit të vogël)	59
Ik moj drenushë	60
Një mashtrim (nipçes)	61
Rrita (Artanit)	62
Shqiponja ime (Arjetës)	63
Pesha e mallit(motrës)	64
Mbesa	65
Udha e kthimit	66
Xhaxhi poet (<i>Fëmijëve të mërgatës</i>)	67
Ikja e dritës (humbja e syve të babait)	69
Malli i atdheut	70
Në shportën e zanave	71
Agullim	72
Cikli i katërt	
Besniku i dashurisë	75
Jetë e vdekje	76
Lumëmalli	77
Një fletë e veçantë	78
Edhe njëherë motrës	79

Mustafë Krasniqi

Shpirtrat e trazuara	80
Kthjellona mendjen	81
Malli	83
Lakmia	84
Kujri zanash	85
Thyerje e vetme	86
Drugëzat (tradhtarëve)	88
Përtej bukurisë	89
Tmerrimi i korbave	90
Le të zhduket nata	91
Karrieristëve	93
O i ziu i fundit	94
Modernizimi i fundit	95
Biografia e autorit	97

Eshtrat Pezull



Botuesi: ShSh Fahri Fazliu Kastriot

Mustafë Krasniqi

Poezi: Eshtrat Pezull

Formati: 13.5 x 20 cm

Tirazhi: 200

Shtypshkronja

“Lena Grafik”

Prishtinë 2016

Katalogimi në botim – **(CIP)** Biblioteka
Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

821.18-1

Krasniqi, Mustafë

Eshtrat pezull : poezi / Mustafë Krasniqi. –
Prishtinë : Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri
Fazliu”, 2016. – 102 f. ; 21 cm.

Biografia e autorit : f. 97-98

ISBN 978-9951-664-27-1